



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Bordi

VENDIM

Nr. 219, datë 20.12.2019

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “HYDRO POWER PANARIT” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
HIDROCENTRALI “VILE” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1994 kW**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a”; 10, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”; si dhe nenit 15 të “Rregullave për Organizimin, Funksonimin dhe Proçedurave të ERE-s, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin me nr.119/1 prot, datë 17.12.2019 të Drejtorisë së Licensimit Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, lidhur me “Licencimin e shoqërisë “Hydro Power Panarit” shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Vile” me kapacitet të instaluar 1994 kw.

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr.157, datë 29.10.2019, “Filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Hydro Power Panariti” shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Vile” me kapacitet të instaluar 1994 kW, për një afat 30 vjeçar”.
- ERE me shkresën nr.32/44 Prot, datë 31.10.2019, ka bërë publikimin në median e shkruar për “Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Vile” dhe ka ftuar palët të bëjnë komente dhe sugjerime.
- ERE me shkresën me nr.587/1Prot, datë 04.11.2019, ka njoftuar shoqërinë lidhur me vendimarrjen e bordit, për “Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Hydro Power Panariti” shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Vile”, si dhe kërkesë për plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- ERE me shkresat nr.587/2 Prot, datë 20.11.2019, nr.587/4 Prot datë 11.12.2019, ka rikujtuar subjektin për plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Shoqëria “Hydro Power Panariti” shpk, me shkresën e protokolluar në ERE me nr.587/3/4 Prot, datë 27.11.2019, ka depozituar dokumentacionin e munguar.

- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare” i ndryshuar. Në datën 29.10.2015, është e regjistruar pranë QKB, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar shpk, konform Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit”, me numër identifikimi (NUIS) L52229023C.
- Objekt i veprimtarisë së këtij subjekti ndër të tjera është dhe: “Ndërtim, operim, shpërndarje, shitje të energjisë elektrike të hidrocentralit mbi lumin Panarit. Prodhim dhe shitje Energjie Elektrike”.
- MIE me miratimin përfundimtar nr. 2441/7 Prot, datë 06.07.2017, ka miratuar ndërtimin e HEC -Vilë me kapacitet prodhues 1994 kW, në ujrat e rrjedhës së mesme dhe të poshtme të luginës së përroit të Panaritit, degë e lumit Osum të qarkut Korçë.
- MIE pas miratimit përfundimtar, ka lidhur me shoqërinë “HYDRO POWER PANARIT” shpk, kontratën me nr. 1951 Rep; nr. 882/2 Kol, datë 04.09.2017 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit Vile me kapacitet prodhues 1994 kW, në ujrat e rrjedhës së mesme dhe të poshtme të luginës së përroit të Panarit, degë e lumit Osum, Qarku Korçë”.
- Kohëzgjatja e kontratës do të jetë 49 vjet nga data e hyrjes në fuqi të saj me të drejtë ripërsëritje.
- Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me Vendimin e bordit nr. 109, datë 29.06.2015 nuk rezultoi të këtë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Hydro Power Panariti”shpk, për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec -Vilë.
- Aplikimi i shoqërisë “Hydro Power Panariti”shpk, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë vijon:
 - Formati i aplikimit (Neni 9, pika 1:gërmat “a”; “b”; “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, (neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, dhe “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik për HEC, (neni 9, pika 4.1.1; pika 4.1.2 ; pika 4.1.3, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; pika 4.1.4 , gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 4.1.5, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Në kuptim të nenit 38 të ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ERE përcakton kushtet që duhet të përmbushen për marrjen e çdo licence, duke marrë në konsideratë, ndër të tjera:a) *afatin e vlefshmërisë së licencës, i cili për veprimtarinë e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes nuk mund të jetë më shumë se 30 vjet;*

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “HYDRO POWER PANARIT” shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC- Vile me fuqi 1994 kW, për një afat 30 vjeçar.
2. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE lejen e Ujit të rinovuar jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të afatit, në datën 11.05.2022.
3. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE lejen e Mjedisit të rinovuar jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të afatit, në datën 03.08.2020.
4. Drejtoria e Licensimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI